



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

### V E N D I M K.P.P. 542/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15/08/2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Security Korça” shpk, për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt: “*Sherbim roje civile Sektori Korce*” (ish *Drejtoria Rajonale Rrugore Korce*) – *Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj*” me nr. REF-68279-05-10-2018, me fond limit 3,124,428 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër .

**Ankimues:** “Security Korça” sh.p.k.

*Adresa: Lagjia 17, ish UMB, T.Sh. Sh Fruta Perimeve*

*Korçë*

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokaster

*Adresa: Ish Zona Industriale*

*Gjirokaster*

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

**II***Rrethanat e çështjes*

II. Në datën 11.05.2018 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me objekt: “Sherbim roje civile Sektori Korce” (ish Drejtoria Rajonale Rrugore Korce) – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj” me nr. REF-68279-05-10-2018, me fond limit 3,124,428 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastër .

II.1. Në datën 22.05.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.2. Në datën 23.05.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku nga verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike rezulton si më poshtë vijon:

1. “Security Korça” shpk	2,915,860.32	lekë	skualifikuar;
2. “Ernisa-S” shpk	2,915,926.45	lekë	kualifikuar;

II.3. Operatori ekonomik “Security Korça” shpk është njoftuar me anë të Sistemit të Prokurimeve Elektronike për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: “ *Oferta e operatorit Security Korca është nën kufirin minimal të kostos ligjore në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, për rrjedhojë skualifikohet.*”

II.3.1. Në datën 28.05.2018, operatori ekonomik ankimues “Security Korça” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.3.2. Në ankesën drejtuar autoritetit kontraktor, pala ankimuese kundërshton vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat se: “[...]

- i. *Ankesa jonë bazohet në ligjin nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi nr.914 datë 29.12.2014 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar ka ndryshuar me vendimi nr.893 datë 21.12.2016 “Për një shtesë në Vendimin nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18 gërma “g” është përcaktuar: “Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në VKM nr.399 datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale” e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në VKM 399 datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale”: 1. Paga minimale mujore për punnjësit në shkallë vendi që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person fizik a juridik vendas ose i huaj të jetë 24,000 ( njëzetë e katër mijë) lekë. Paga minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. 3. Paga minimale, orare të jetë 138 ( njëqind e tridhjetë e tetë) lekë. 4. Shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë. Në nenin 81 të “Kodit të Punës” është parashikuar “Çdo orë punë e kryer nga ora 19:00 deri në orën 22:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 % dhe çdo orë punë e kryer midis intervalit 22:00 dhe 6:00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50 % ndërsa referuar nenit 87, po*

këtu “puna e kryer ditën e pushimit javor, ose në ditët e festave zyrtare kompensohet me një shtesë page jo më pak se 25 % ose me një pushim të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë jo më pak se 25 përqind të kohëzgjatjes së kësaj pune që merret nëj jave para ose pas kryerjes së saj. Kontributi i detyrueshëm për sigurime shëndetësore i të punësuarit, duke filluar nga pjesa e punëdhënësit është 16.7 % referuar VKM-së nr.77 datë 28.01.2015 Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shqoërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor. Rekomandimi i APP dhe KPP datë 20.12.2017 mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike. Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar me ligjin nr.7961 datë 12.7.1995, ligji nr.136/2015 për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7961 datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, ligji nr. 136/2015 datë 5.12.2015) neni 77, kohëzgjatja ditore e punës, kohëzgjatja e punës dhe pushimi ditor, neni 78, pushimet, neni 79, neni 79/1 puna me turne, neni 80 puna e natës, neni 81 shtesat mbi pagë, pushimi javor, neni 85 ditët e festave zyrtare, neni 86 puna në ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare, neni 87, kompensimi, neni 91 pushimet vjetore kohëzgjatja, neni 92 data e pushimeve vjetore, neni 93 paga, neni 94 paga që paguhet për lejen vjetore, paga minimale, neni 111 ( i ndryshuar pika 3 me ligjin nr.136/2015 datë 5.12.2015) zbritjet nga paga neni 117 përllogaritja e pagës, neni 119. Licencë për ushtrimin e aktivitetit lëshuar nga QKL që përmban kategorinë I.3.A “Shërbime të ruajtjes së personave, objekteve e veprimtarive” konform ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në RSh, në ligjin nr. 9723 datë 03.05.2007 për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, neni 62 pargarafi 2, nipt sekondar sipas ligjit nr.9723 datë 03.05.2007 “Për qendrën kombëtare të regjistrimit” ( i ndryshuar). Të gjitha detyrimet ligjore të përcaktuara në ligjin nr.75/2014 “Për shpsf” në përputhje të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë publike”, neni 3 pika 18 si edhe udhëzimit nr.157 datë 01.04.2015 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, kreu iii pika 9/c/d. Në zbatim të ligjit nr.75/2014 datë 10.7.2014 “Për shërbimin prvat të sigurisë fizike neni 18 shkronja “g” paga e punonjësit rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me Vendim të Këshillit të Ministrave. Në total paga bazë 22000+11000 ( 50 % sipas ligjit të sipërcituar) = 36000 lekë:174 orë në muaj= 206.89 lekë/ora. Për sistemin e taksave vendore ligj nr.9632 datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin 9745 datë 28.5.2007 ( qkr) ndryshuar me ligjin 9931 datë 09.06.2008 ndryshuar me ligjin 10073 datë 29.9.2009 ( në fuqi nga 28.10.2009) ndryshuar me ligjin nr.10354 datë 18.11.2010 ( në fuqi nga 1 janar 2011), ndryshuar me ligjin nr.106/2013 datë 28.03.2013 i ndryshuar me ligjin nr.181/2013 datë 28.12.2013 ndryshuar me ligjin nr.85/2014 datë 01.08.2014; Ligji nr.9920 datë 29.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Duke u bazuar në Rekomandimin e Agjencisë së Prokurimit Publik dhe Komisionit të Prokurimit Publik nr.15166 prot dhe nr.1858 prot datë 20.12.2017 “Mbi

*mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike” në të cilin përcaktohen të gjithë elementët e domosdoshëm për këtë shërbim.....*

- ii. *Shoqëria SHPSF “Security Korça” shpk koston për mënyrën e përllogaritjes së zërave të mëposhtëm për një roje në muaj e ka marrë referuar Vendimit KPP 29/2018 nr.1881 protokollin datë 22.12.2017 pikës III.19.. Në zbatim dhe referim të kësaj kostoje në mënyrën e përllogaritjes jemi bërë dhe analizat e kostos si më poshtë vijon:*
- iii. *Mënyra si e llogarit KPP koston për një roje në muaj. Paga bazë minimale mujore = 36000 lekë; Shtesat turni II ( 206.89 lekë/ora x20 % = 41.37 lekë x3 orë ( ora 19:00-22:00) = 124.11 lekë x 30.41 ditë= 3774.18 lekë/ 5 roje 754.83 lekë. Shtesat turni II ( 206.89 lekë ora\*20 % = 41.37 lekë x3 orë ( ora 19:00-22:00) = 124.11 lekë x 30.41 ditë = 3774.18/5 roje= 754.83 lekë. Shtesat turni III ( 206.89 lekë/ora x 50 %=103.44 lekë x8 orë ( ora 22:00-6:00)= 827.52 lekë\*30.41 ditë= 25164.88 lekë/5 roje=5032.97 lekë. Kontributet në masën 16.7 % = 36000+754.83 +5032.97\*16.7%= 6978.56 lekë. Totali për një roje në muaj minimalisht = 36000+754.83+5032.97+6978.56=48,766.36 lekë.*
- iv. *Duke patur parasysh fondin limit të përllogaritur nga autoriteti kontraktor: Fondi i marrëveshjes kuadër për 12 muaj:3124428 lekë pa TVSH, kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:12 muaj, afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje data 22.05.2018 ora 10:00.*
- v. *Shoqëria “SHPSF “Security Korça” shpk ka përgatitur ofertën ekonomike duke mbajtur parasysh mënyrën e llogaritjes së kostos që KPP llogarit për një roje një muaj, duke iu referuar Autoriteti Kontraktor Drejtoria Rajonit Jugor Gjirokastër për koston ditore, mujore, vjetore, kemi përgatitur ofertën si më poshtë vijon:*
- vi. *Paga minimale- Në vlerën = 3600 lekë ( sipas VKM për pagën minimale) /30.41 ditë muaj=1183.82 lekë dita për 1 roje. Shtesat e turnit të dytë – Në vlerën 206.89 lekë/ora x 20 %= 41.37 lekë x 3 orë = 124.11/4.98 roje = 24.92 lekë dita/1 roje. Shtesat për tunirn e tretë. Në vlerën 206.89 lekë/ora x 50 %= 103.44 x 8 orë = 527.52/4.98 roje= 166.16 lekë/dita për 1 roje. Kontributi në masën 16.7 % = 1183.82+24.92+166.16=1374.90\*16.7 %=229.6 lekë/dita për 1 roje. Totali për një roje në ditë minimalisht= 1183.82+24.92+166.16+229.6=1604.5 lekë dita për 1 roje.[...]”*

II.4. Në datën 29.05.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 353 protokollin datë 29.05.2018 i kthen përgjigje palës ankimuese “Security Korça” shpk duke mos pranuar ankesën.

II.4.1. Në kthim përgjigje, autoriteti kontraktor argumenton në mënyrë të përmbledhur se: “Duke patur parasysh pretendimet e dhëna më sipër u konstatua se: Në dokumentat standarde për këtë procedurë të vëna nga autoriteti kontraktor ndërmjet të tjerave në shtojcën 8 “Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/kualifikimit, pika 2.3 pika 7 është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesi analizën e kostos për ofertën e paraqitur ( Shih shtojca 1-Sqarime). Sipas ofertës të paraqitur nga SHPSF “Security Korça” shpk është bërë llogaritja e kostos mbi bazë ditore dhe

jo në bazë mujore siç e parashikon rekomandimi i përbashkët i dy institucioneve kryesore të prokurimit publik APP dhe KPP datë 20.12.2017 “Rekomandim për zhvillimin e procedurës të shërbimit privat të sigurisë fizike”, i ndryshuar me rekomandimin nr.2511 prot dhe 322 prot datë 20.02.2018. Në rekomandim thuhet: Duke qenë se periudha kohore nga data e lidhjes së kontratës deri në përfundimin e objektit të prokurimit në shumicën e rasteve nuk përkon me periudhën e parashikuar në dokumentat e tenderit, lidhur me afatet e ekzekutimit të kontratës ( për shkaqe të autoritetit kontraktor ose jashtë kontrollit të tij) rekomandohen autoritetet kontraktore të kërkojnë në dokumentat e tenderit që operatorët ekonomikë të paraqesin oferta ekonomike bazuar në kosto mujore dhe totale të kryerjes së shërbimit të ruajtjes me roje”. Në bazë të shtojcës nr.1 “Formulari i Ofertës” të dokumenteve standarde të tenderit formulari i ofertës është si më poshtë vijon:

*Shtojca 1*

[ Shtojcë për t’u plotësuar nga operatori ekonomik]

#### **FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE**

Emri i Ofertuesit \_\_\_\_\_

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

\* \* \*

Procedura e prokurimit: [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/ Nr.Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

1. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; pa TVSH;
  2. Çmimi total i ofertës sonë është [monedha dhe vlera e ofertës]; me TVSH
- 1      2      3      4      5      6      7

Nr

Përshkrimi i Shërbimeve

Njësia

(Muaj)

Sasia

(nr.vendrojeve)

Numri total i rojeve për vendroje

Çmimi Njësi /muaj

Oferta në total (neto)

1.	Sherbim Roje Civile Sektori Korçe.	12	1	4.98	(X)	(X)	
	Oferta Neto ne total						
	TVSH						(%)
(X)							
	Oferta						total
(X)							

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

Ndërsa formulari i ofertës i paraqitur nga operatori ekonomik SHPSF “Security Korça” shpk është si më poshtë vijon..... Përsa më sipër duket qartë se operatori ekonomik “SHPSF Security Korça” shpk nuk ka përdorur formularin standard të ofertës sipas dokumenteve të tenderit, por ka ndryshuar formularin e ofertës. Në këtë formular duket qartë që llogaritja është bërë mbi bazë ditore. Në ligjin “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 53 pika 5 c thuhet Autoriteti kontraktor nuk e pranon një ofertë c) kur oferta e tij nuk përputhet me specifikimet e përcaktuara në dokumentet e tenderit, me përjashtim të rasteve të parashikuara në nenin 54 të këtij ligji. Përsa më sipër oferta skualifikohet edhe për këtë shkëlqje ligjore pasi operatori ekonomik ka ndryshuar formularin e ofertës të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit. Gjithashtu, në bazë të Rekomandimit për Zhvillimin e procedurës të shërbimit privat të sigurisë fizike” datë 20.12.2017 të APP dhe ZKPP i ndryshuar me rekomandimin nr.2511 prot dhe 322 prot datë 20.02.2018, autoriteti kontraktor ka bërë llogatijejet e kostos minimale mujore si më poshtë:

Shpenzime për pagën bazë 36,000

Shpenzime për pagë turni i dytë 758.01

Shpenzime për pagë turni i tretë 5053.43

Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7 % 6982.51

Cmimi për njësi për një roje në muaj 48793.95

Autoriteti kontraktor çdo ofertë nën këtë vlerë mujore e ka skualifikuar për mospërmbushje të kriterit të kostos minimale ligjore. Pra dhe për këtë pikë operatori ekonomik skualifikohet. Kjo ka ndodhur dhe në procedurën tjetër analoge të zhvilluar nga autoriteti kontraktor “Shërbim roje civile Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirkoastër”, ku operatorët ekonomik nën këtë kosto minimale ligjore janë skualifikuar.

II.5. Në datën 06.06.2018 operatori ekonomik ankimues “Security Korça” shpk ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Në datën 20.06.2018 me anë të shkresës nr.402 protokoli datë 18.06.2018, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

Pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashëkngjitur, dokumentave të dërguar nga autoriteti kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Security Korça” shpk për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se : “ *Oferta e operatorit Security Korca është nën kufirin minimal të kostos ligjore në bazë të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, për rrjedhojë skualifikohet.*” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. *Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:*

a) *anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*

b) *zgjdhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*



*c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*

*ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

*2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.*

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.1.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomikë – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.1.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të

papërgjegjshme, duke kryer përlllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimes duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.1.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kritere në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo nësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

*2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.*

*3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.*

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori

ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.1.8. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, Shtojca 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi parashikohet si më poshtë:

<i><b>1</b></i>	<i><b>2</b></i>	<i><b>3</b></i>	<i><b>4</b></i>	<i><b>5</b></i>	<i><b>6</b></i>	<i><b>7</b></i>
<i><b>Nr</b></i>	<i><b>Përshkrimi i Shërbimeve</b></i>	<i><b>Njësia (Muaj)</b></i>	<i><b>Sasia (nr.vendroje ve)</b></i>	<i><b>Numri total i rojeve për vendroje</b></i>	<i><b>Çmimi Njësi /muaj</b></i>	<i><b>Oferta në total (neto)</b></i>
<i><b>1.</b></i>	<i>Sherbim Roje Civile Sektori Korce.</i>	<i><b>12</b></i>	<i><b>1</b></i>	<i><b>4.98</b></i>	<i><b>(X)</b></i>	<i><b>(X)</b></i>
	<i><b>Oferta Neto ne total</b></i>					
	<i><b>TVSH (%)</b></i>					<i><b>(X)</b></i>
	<i><b>Oferta total</b></i>					<i><b>(X)</b></i>

Nënshkrimi i ofertuesit \_\_\_\_\_

Vula \_\_\_\_\_

### **Sqarime**

- 1. Ne çmim jane te perfshira te gjitha shpenzimet per detyrimet fiskale qe parashikon kuadri ligjor ne lidhje me pagat, shtesat mbi page, sigurimet shoqerore dhe shendetesore per sherbimin e ruajtjes ne nje vend roje me tre turne.*
- 2. Bashkelidhur formularit te çmimit te ofertet te paraqitet preventivi per nje roje dhe 1 vend-roje me 3 turne (4.98 roje) në muaj, sipas tabelës së mëposhtme.*

<i><b>Nr.</b></i>	<i><b>Emërtimi</b></i>
-------------------	------------------------

1	Shpenzime për pagë bazë
2	Shtesë mbi pagë për turnin II
3	Shtesë mbi pagë për turnin III
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%

### Analiza e kostos

- Operoret janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 03.05.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".
- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për një vëndroje me tre turne të llogaritet **4.98** (Ore pune/punonjes/muaj: **174 ore**). Koeficienti i zëvendësimit 1.66 për çdo punonjës shërbimi).
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehën në Monedhën Lek ( e kërkuar në dokumentat e tenderit ).
- **Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total.**

III.1.9. Në shtojcën 8 "Specifikimet Teknike" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekti ankimi përcaktohet si më poshtë:

### SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Ne këtë objekt parashikohet ruajtja e zyrave ,ambienteve ndihmese ,mjeteve dhe territorit të Sektorit Korce (ish Drejtorise Rajonale Rrugore Korce).

Zyrat e ish Drejtorise Rajonale Rrugore Korce ndodhen në qytetin e Korces dhe aktualisht perdoren nga punonjesit e Sektorit Korce. Territori ku janë ndertuar zyrat dhe ambientet

*ndihmese te ish Drejtorise Rajonale Rrugore Korce ze nje siperfaqe prej 4000m2, territori eshte i rrethuar me mur guri.*

*Ne hyrje te territorit ndodhen repartet ndihmese dhe garazhet.Garazhet jane te mbyllura me dyer metalike dhe jane te pajisura me dyer me brave sigurie .Gjithashtu dhe repartet ndihmese jane te pajisura me dyer me brave sigurie*

*Ne territorin e ish Drejtorise parkohen mjete si kamiona,fadroma,borepastruese ,automjetet e personelit drejtues dhe materiale te ndryshme ndertimi si tubo, elemente betoni, materiale inerte etj. Te cilat perdoren per nevoja pune te Drejtorise ne raste emergjente.*

*Personeli i Drejtorise eshte i pranishem gjate orarit zyrtar prej ores 8.00 deri ne oren 16.00.Gjate kesaj kohe ne territorin e Drejtorise ka hyrje dalje te personelit si dhe te automjeteve.Gjithashtu mund te hyjne dhe persona te autorizuar nga Drejtoria. Ne raste nevoje dhe emergjencash do te punohet edhe jashte orarit zyrtar.*

*Shërbimi në një vendroje në hyrjen kryesore me tre turne në të gjitha ditët kalendarike për të cilën lidhet kontrata. (24 orë në ditë)*

*Skicimet, parametrat teknik etj*

*Gjatë turneve të dyta dhe të treta rojet të kryejnë kontrolle çdo 15 minuta në të gjitha hapësirat e objekteve.*

*Kërkesat për zbatimin e shërbimit*

*Punonjësit e shërbimit të jenë të licensuar me lejet përkatëse të lëshuara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut ku prokurohet në bazë të Ligjit Nr. 8770, datë 19.04.2001 “Për SHRSF”.*

*Punonjësit e shërbimit të jenë të pajisur me uniformë të rregullt të miratuar nga Ministria e Brendshme, ku të jetë e reklamuar dhe stema e shoqërisë dhe të kenë dokumenta që vërtetojnë identitetin e tyre*

*Rojet duhet të kenë në përdorim për realizimin e shërbimit të ruajtjes, radio komunikimi.*

*Rojet duhet të kenë leje arme.*

*Rojet e turnit të tretë të jenë te pajisur me armë*

*Në vend roje duhet të jenë këto dokumenta:*

*a-Rregullorja e brendshme*

*b-Libri i marrjes në dorëzim të shërbimit, i cili duhet të plotësohet nga punonjësi i shërbimit.*

*c-Grafiku mujor i shërbimit me emrat e personelit për çdo ditë dhe turn.*

*d-Mjete ndriçimi në rast mungese te energjise elektrike.*

*e-Numrat telefonik të rajoneve të policisë, zjarrëfikseve dhe të personave kryesorë përgjegjës të objektit.*

*f-Skemën e njoftimit në rast sulmi ose zjarri në objekt.*

*g-Listën e automjeteve që lejohen të hyjnë apo të parkohen në objekt.*

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka kërkuar shprehimisht se të gjithë ofertuesit, në ofertën e tyre ekonomike, duhet të parashikojnë të gjitha detyrimet ligjore për kryerjen e këtij shërbimi; pra më konkretisht ofertuesit duhet të përllogarisin pagën bazë minimale ligjore në vlerën prej 36.000 lekë, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur nga ankimuesi, dokumentacionin e dorëzuar nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës së operatorit ekonomik “Security Korça” shpk dhe konkretisht elementëve bazë (pagë bazë, shtesa mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë, si dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%) –elementë këta të cilat janë përcaktuar shprehimisht dhe në DST-; Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Security Korça” shpk, dhe konkretisht elementët bazë të ofertës së tyre për një vendroje në muaj për të gjithë periudhën e shërbimit, sipas përcaktimit të bërë në dokumentat e tenderit, ku është parashikuar se *Klasifikimi i ofertave bëhet mbi bazën e vlerës së ofertës së dhënë në total*, konstaton se oferta për një vendroje me 4.98 roje, me tre turne për gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit për 12 muaj, e paraqitur nga operatori ekonomik “Security Korça” shpk, rezulton të jetë nën minimumin e lejuar ligjor të këtij shërbimi. Komisioni sqaron se ka qënë detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur nga secili prej tyre të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga autoriteti kontraktor me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Security Korça” shpk nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

#### **Vendos:**

1. Të mos pranohet ankesën e operatorit ekonomik “Security Korça” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me objekt: “*Sherbim roje civile Sektori Korce*” (ish Drejtoria Rajonale Rrugore Korce) – *Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj*” me nr. REF-68279-05-10-2018, me fond limit 3,124,428 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 22.05.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Jugor Gjirokastrë .
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.

4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1066 protokoli Datë 06.06.2018;**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

<b>Nënkryetar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Enkeleda Bega</b>	<b>Vilma Zhupaj</b>	<b>Lindita Skeja</b>	<b>Merita Zeqaj</b>

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**